

Shkodër, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Blerje automjesh elektrike**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34144900-7 - Automjete elektrike,

VLERA E FONDIT LIMIT: **11,000,000 (njëmbëdhjetë milion) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Bashkia Shkodër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 9).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **4,400,000 (katërmilion e katërqind mijë) lekë**.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar “*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën*”, “*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:* b) vlerën e përllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj furnizimesh, sasinë dhe cilësinë e mallit objekt procedure prokurimi, afatin e kontratës dhe eksperiencat e mëparshme nga AK Bashkia Shkoder dhe Autoritete të tjera kontraktore kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **4,400,000 (katërmilion e katërqind mijë) lekë** që është sa 40% e vlerës së fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomikë pasi duke parë edhe eksperiencat e mëparshme ata mund të ofertojnë si bashkim operatorësh.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të **ligjit Nr. 29/2023** “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve **2023-2024-2025** të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e pasqyrave financiare është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Kjo kërkesë synon të verifikojë kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë dhe aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

Përcaktimi i periudhës për të cilën kërkohen pasqyrat financiare bazohet në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat dhe kontabilitetin. Konkretisht, ligji nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikon detyrimin e tatimpaguesve që mbajnë kontabilitet për paraqitjen e deklaratës vjetore së bashku me pasqyrat financiare. Ndërkohë, ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” përcakton detyrimin për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Në këtë kuadër, kërkesa për paraqitjen e pasqyrave financiare për tre vitet e fundit është në përputhje me nenin 43, pika 4, të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar, i cili lejon kërkimin e bilanceve për një periudhë prej maksimumi tre viteve të fundit financiare. Kjo i mundëson autoritetit/entit kontraktor të krijojë një pamje më të plotë mbi gjendjen financiare dhe qëndrueshmërinë ekonomike të operatorit, pa vendosur një kërkesë të pajustificuar apo të tepruar.

Sa i përket akt-ekspertizës/raportit të auditimit ligjor, ai kërkohet vetëm për operatorët ekonomikë që, sipas nenit 41 të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, janë subjekt i detyrimit ligjor për auditimin e pasqyrave financiare. Për operatorët që nuk përfshihen në kategoritë e përcaktuara nga ky ligj, nuk kërkohet një dokument i tillë.

Në përfundim, kërkesat e mësipërme janë vendosur për të siguruar një vlerësim të arsyeshëm dhe objektiv të kapacitetit ekonomik e financiar të operatorëve ekonomikë, janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe respektojnë parimin e proporcionalitetit, duke kërkuar vetëm dokumentacionin që është i nevojshëm për vlerësimin e aftësisë së operatorit për realizimin e kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për vitin 2025 (Sipas QKB) si dhe këstet e maturuara për vitin 2026 sipas përcaktimeve në

ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sic kërkohej në piken 2.2.3, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr. 131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Megjithatë operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate në një vlerë prej **4,400,000 (katër milion e katërqind mijë) lekë.**

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohej:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa për dëshmimin e përvojës së mëparshme në furnizime të ngjashme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe neni 40, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në bazë të këtyre dispozitave, autoriteti/enti kontraktor mund të vendosë kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet teknike dhe profesionale, si dhe përvojën e nevojshme për të realizuar kontratën sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Për kontratat e mallrave, përvoja e mëparshme dëshmohet nëpërmjet furnizimeve të ngjashme të realizuara me sukses gjatë periudhës së përcaktuar nga rregullat e prokurimit publik, ndërsa vlera e kërkuar duhet të jetë brenda kufirit të lejuar nga legjislacioni.

Në rastin konkret, autoriteti/enti kontraktor ka përcaktuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë realizimin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej **40% të fondit limit**. Ky nivel është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën dhe rëndësinë e objektit të prokurimit, vlerën e kontratës, kompleksitetin e furnizimit dhe nevojën për të garantuar që operatori ekonomik disponon përvojë reale dhe të mjaftueshme për realizimin me sukses të kontratës.

Përcaktimi i këtij kriteri nuk synon të favorizojë operatorë të caktuar apo të ngushtojë në mënyrë të pajustificuar konkurrencën, por të sigurojë një nivel minimal të besueshëm të kapacitetit profesional. Fakti që një operator ekonomik ka realizuar më parë furnizime të ngjashme në një vlerë të konsiderueshme përbën një tregues objektiv se ai ka kapacitetin organizativ, teknik dhe logjistik për të përballuar furnizimin objekt kontrate.

Vlera prej **40%** është vendosur brenda kufirit maksimal të lejuar nga kuadri rregullator dhe është konsideruar e përshtatshme në raport me vlerën dhe karakteristikat e kontratës. Në përcaktimin e saj janë mbajtur në konsideratë edhe nevojat konkrete të autoritetit kontraktor dhe përvoja e mëparshme në realizimin e furnizimeve të kësaj natyre.

Ky kriter është veçanërisht i rëndësishëm në rastin e një kontrate furnizimi, pasi realizimi i saj nuk lidhet vetëm me disponueshmërinë e mallrave, por edhe me aftësinë e operatorit për t'i siguruar, transportuar dhe dorëzuar ato në përputhje me sasinë, afatet, specifikimet teknike dhe kërkesat e cilësisë të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për rrjedhojë, kërkesa për furnizime të ngjashme në vlerën 40% të fondit limit është **e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, e nevojshme dhe proporcionale me natyrën, vlerën dhe shkallën e përgjegjësisë që mbart realizimi i saj**. Ajo i shërben autoritetit/entit kontraktor për të ulur rrezikun e mosrealizimit ose realizimit me vonesa dhe/ose me cilësi të papërshtatshme të furnizimit.

Sa më sipër, kërkesa për dëshmimin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme, në një vlerë prej **40% të fondit limit**, synon të garantojë që operatori ekonomik i përzgjedhur të ketë një përvojë të provuar dhe kapacitet të mjaftueshëm për realizimin me sukses të kontratës së furnizimit, duke ruajtur njëkohësisht parimet e proporcionalitetit, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 40, pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Kjo kërkesë synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon kapacitetet dhe lidhjet e nevojshme profesionale për furnizimin e mallit objekt prokurimi dhe për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me të gjatë periudhës së garancisë. Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar shërben si një dokument objektiv për të provuar se operatori ekonomik është i autorizuar të ofrojë dhe tregtojë mallin përkatës dhe se furnizimi realizohet përmes një kanali të identifikueshëm dhe të verifikueshëm. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për objektin e prokurimit, pasi përveç furnizimit të mjetit, kontrata lidhet edhe me garantimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve gjatë periudhës së garancisë.

Në rastin kur autorizimi lëshohet nga një distributor i autorizuar, kërkesa për të provuar marrëdhënien e autorizimit ndërmjet distributorit dhe prodhuesit siguron që kjo lidhje të jetë reale dhe e verifikueshme dhe shmang paraqitjen e autorizimeve nga subjekte që nuk kanë marrëdhënie të autorizuar me prodhuesin. Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, i nevojshëm për verifikimin e kapacitetit dhe besueshmërisë së operatorit ekonomik dhe proporcional me natyrën e furnizimit, pa synuar kufizimin e konkurrencës apo favorizimin e një operatori, marke ose prodhuesi të caktuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **katalogun teknik** të mjeteve të ofruara, të lëshuar nga prodhuesi ose burim zyrtar i tij, në gjuhën shqipe ose të shoqëruar me përkthim në gjuhën shqipe; në katalog duhet të markohen qartë specifikimet teknike përkatëse të modelit të ofruar, për lehtësi identifikimi dhe verifikimi të përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e katalogut teknik të mjeteve të ofruara është përcaktuar në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në lidhje me nenin 77, pika 1, të këtij ligji, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja “b”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Sipas këtij kuadri ligjor, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të përcaktojë në dokumentet e tenderit karakteristikat dhe kërkesat teknike të furnizimit dhe të kërkojë dokumentacion të përshtatshëm për të verifikuar pajtueshmërinë e produktit të ofruar me këto specifikime.

Katalogu teknik përbën një dokument të përshtatshëm dhe objektiv për verifikimin e karakteristikave të autoveturës, si dhe për identifikimin e modelit dhe parametrave teknikë të saj. Për këtë arsye, kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë katalogun teknik dhe të markojë në të specifikimet përkatëse synon të lehtësojë dhe të bëjë të qartë procesin e verifikimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duke mundësuar krahasimin e drejtpërdrejtë të të dhënave të mallit të ofruar me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është e nevojshme për verifikimin e përputhshmërisë teknike të autoveturës dhe nuk synon kufizimin e konkurrencës apo favorizimin e një marke ose modeli të caktuar.

Në përputhje edhe me nenin 36 të LPP-së, specifikimet teknike duhet të përcaktojnë qartë karakteristikat e furnizimit që prokurohet dhe të hartohen në mënyrë të tillë që të garantojnë konkurrencë të paanshme dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë. Për rrjedhojë, kërkesa për katalogun teknik dhe markimin e specifikimeve përkatëse është proporcionale me objektin e kontratës dhe i shërben qëllimit të verifikimit objektiv, transparent dhe të njëtrajtshëm të përputhshmërisë së autoveturës së ofruar me kërkesat teknike të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se disponon ose ka në dispozicion një servis të specializuar, të autorizuar nga prodhuesi/distributori, për kryerjen e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së autoveturave objekt prokurimi gjatë gjithë periudhës së garancisë. Servisi mund të jetë *në pronësi* të operatorit ekonomik, *i marrë me qira* ose i siguruar nëpërmjet një *kontrate bashkëpunimi*, e vlefshme gjatë periudhës së realizimit të kontratës. Në deklaratë duhet të përcaktohet adresa e plotë e servisit.

Argumentim: Kërkesa për disponimin ose sigurimin e një servisi të specializuar dhe të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, pasi përmbushja e kontratës nuk kufizohet vetëm në furnizimin dhe dorëzimin e mallrave/**automjeteve**, por përfshin edhe garantimin e mirëmbajtjes dhe riparimeve gjatë periudhës së garancisë. Në këtë kuadër, disponimi i një servisi të specializuar dhe të autorizuar siguron që ndërhyrjet teknike, mirëmbajtja dhe riparimet e nevojshme të kryhen nga një subjekt me kapacitetet dhe autorizimet përkatëse, duke garantuar ruajtjen e kushteve të garancisë dhe funksionimin e rregullt të mjetit.

Kjo kërkesë i jep Autoritetit Kontraktor sigurinë se operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij gjatë gjithë periudhës së garancisë dhe redukton rrezikun e ndërprerjes së përdorimit të autoveturës, vonesave në riparime apo mosrealizimit të detyrimeve të garancisë. Në respektim të parimit të proporcionalitetit, kriteri nuk kërkon që servisi të jetë domosdoshmërisht në pronësi të operatorit ekonomik, por lejon që ai të jetë në dispozicion nëpërmjet pronësisë, qirasë ose një kontrate bashkëpunimi të vlefshme për periudhën e garancisë. Në këtë mënyrë, kërkesa u jep mundësi operatorëve ekonomikë të organizojnë kapacitetet e nevojshme sipas mënyrës së tyre të organizimit, duke shmangur një kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

Ndërsa, përcaktimi i adresës së servisit synon vetëm të mundësojë identifikimin dhe verifikimin e tij nga Autoriteti Kontraktor. Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është i nevojshëm dhe proporcional me natyrën e furnizimit dhe synon të garantojë realizimin e plotë dhe cilësor të detyrimeve kontraktore, veçanërisht atyre që lidhen me garancinë dhe shërbimin pas shitje

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë:

a) që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mjeteve, për një periudhë jo më pak se 7 (shtatë) vite ose 150,000 Km.

b) ku të specifikojë cilat nga pjesët teknike të automjetit janë brenda garancisë.

Argumentim: Në mbështetje të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “**Për prokurimin publik**”, si dhe pikës 8 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “**Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**”, Autoriteti Kontraktor përcakton si kërkesë që operatorët ekonomikë të deklarojnë periudhën dhe kushtet e garancisë që ofrojnë për mjetet objekt prokurimi.

Kërkesa për një periudhë garancie prej **jo më pak se 7 vite ose 150,000 km** synon të sigurojë që mjetet e prokuruar të jenë të përshtatshme për përdorim afatgjatë dhe që Autoriteti Kontraktor të ketë mbulim të mjaftueshëm ndaj defekteve apo problematikave teknike që mund të shfaqen gjatë përdorimit të tyre. Përcaktimi i periudhës së garancisë lidhet me nevojën për të garantuar qëndrueshmërinë, besueshmërinë dhe funksionalitetin e mjeteve gjatë ciklit të tyre të përdorimit.

Gjithashtu, kërkesa që operatori ekonomik të specifikojë pjesët, komponentët dhe sistemet teknike të përfshira në garanci synon të përcaktojë në mënyrë të qartë **shtrirjen e detyrimit të garancisë**, duke shmangur paqartësitë gjatë zbatimit të kontratës. Në rast të shfaqjes së defekteve të mbuluara nga garancia, operatori ekonomik kontraktues do të jetë përgjegjës për kryerjen e riparimeve, zëvendësimeve dhe shërbimeve përkatëse, në përputhje me kushtet e garancisë së deklaruar dhe detyrimet kontraktore.

Ky kriter është i lidhur dhe proporcional me objektin e prokurimit, pasi synon të mbrojë interesin e Autoritetit Kontraktor dhe të garantojë vazhdimësinë e funksionimit të mjeteve, duke minimizuar kostot dhe rreziqet që mund të lindin nga defektet teknike gjatë periudhës së garancisë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se dorëzimi i mjeteve do të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Çertifikatën e pronësisë së mjetit (në emër të AK)
- Lejen e qarkullimit të mjetit (në emër të AK)
- Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (në emër të AK)
- Policen e sigurimit (në emër të AK)
- Taksen e qarkullimit

Argumentim: Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “**Për prokurimin publik**”, i ndryshuar si dhe pikës 6, shkronja “b”, të nenit 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “**Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**”, i ndryshuar Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kërkesa që lidhen me aftësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur objektin e kontratës dhe me dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e saj. Vendosja e këtij kriteri synon të garantojë që, në momentin e dorëzimit, mjetet objekt të kontratës të jenë të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm të pronësisë, regjistrimit, kontrollit teknik, sigurimit dhe pagesës së detyrimeve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesa për dorëzimin e dokumentacionit në emër të Autoritetit Kontraktor lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të siguruar që mjetet të jenë të regjistruara dhe të pajisura me dokumentacion

të rregullt dhe të vlefshëm, duke mundësuar përdorimin e tyre në mënyrë të ligjshme dhe të menjëhershme pas dorëzimit.

Ky kriter i shërben gjithashtu Autoritetit Kontraktor për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve ligjore që lidhen me regjistrimin, qarkullimin, kontrollin teknik, sigurimin dhe taksimin e mjeteve, si dhe për të shmangur çdo pengesë administrative apo ligjore që mund të ndikojë në përdorimin e tyre pas marrjes në dorëzim.

Për rrjedhojë, kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon të sigurojë përmbushjen e plotë të detyrimeve kontraktuale nga operatori ekonomik, si dhe dorëzimin e mjeteve të gatshme për përdorim nga Autoriteti Kontraktor.

V.O Ofertuesit ne plotesimin e ofertes se tyre nuk duhet të kalojnë vlerën e fondit limit të secilës drejtori te percaktuar me lart. Mosplotesimi i kesaj pike do sjell skualifikimin e ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të

*rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance,apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. si dhe me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

BASHKELIDHUR DST